

UDHËZIM
Nr. 10, datë 26.2.2021

**MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCEDURAVE TË
PËRQENDRUARA TË PROKURIMIT PUBLIK PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR
AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si rezultat i mungesës së kapaciteteve në institucionet e varësisë për realizimin me sukses të procedurave

UDHËZOJ:

1. Realizimin e procedurave, me vlerë mbi 800,000 (tetë qind mijë) lekë pa TVSH në mënyrë të përqendruar për Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
 2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural merr përsipër rolin e Organit Qendror Blerës për zhvillimin e procedurave së prokurimit në emër dhe për llogari të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
 3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurave të prokurimit sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, që nga hartimi i specifikimeve teknike, njoftimi i kontratës e deri te publikimi i njoftimit të nënshkrimit të kontratës në sistemin elektronik të prokurimeve.
 4. Pas njoftimit të fituesit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dërgon pranë Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, dokumentacionin e plotë në formë të shkruar për të vijuar me nënshkrimin e kontratës përkatëse.
 5. Për procedurat e prokurimit të cilat realizohen nga ABP dhe/ose AKSHI, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, merr përsipër hartimin e specifikimeve teknike, si dhe dërgimin e tyre pranë autoriteteve përkatëse.
 6. Autoriteti Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve është përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e kontratës.
 7. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve do të jetë përfituesi i mallrave/shërbimeve/punëve objekt prokurimi.
 8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi